



Misioni ynë

Revistë informative, kulturore dhe shpirtërore, viti II, nr.8, tetor-dhjetor 2022



Simbolet e Krishtlindjes dhe domethënia e tyre

Faqe 28-29



(Foto: nga Arkivi)

Shumë besimtarë edhe pse nuk praktikojnë pjesëmarrjen në Meshën e shenjtë çdo të dielë, kanë dëshirë dhe kërkojnë që meshtari të kalojë dhe të bekojë shtëpinë dhe familjen e tyre. Kjo traditë fetare është gjë e bukur, jo vetëm për familjarët, por edhe për meshtarin, pikërisht për arsye sepse është një rast i bukur për të njohur dhe kuptuar më mirë realitetin në të cilin jetojnë familjet.

Në traditën tonë shqiptare, bekimi i shtëpive, bëhet kryesisht në periudhën e festave të Krishtlindjes, pra nga Dita e Ujit të bekuar (6 janar), deri në festën e Pashkëve. Por, kjo nuk do të thotë se bekimi nuk mund të bëhet edhe pas të krenntes së Pashkëve.

Në Misionin tonë në Luzern, meqenëse numri i familjeve është i madh, përafërsisht 5.000 familje, të shpërndara në 8 Kantone, kërkesa për bekim, pothuajse, vazhdon gjatë tërë vitit. Viteve të fundit, për arsye të Pandemisë, nuk kemi arritur të bekojmë të gjitha familjet, por, këtë vit, falë meshtarëve që do të vijnë nga Kosova dhe Shqipëria, urojmë të bëjmë bekimin e të gjitha familjeve.

Bekimi i shtëpive, i gjërave, i fëmijëve, i të sëmurëve etj., ka një bazament biblik: Hyji bekon njerëzit e parë dhe u thotë të shumohen

me të mira (krhs. Zan 1, 26). Edhe Jezusi, në momente dhe vende të ndryshme, bekon fëmijët, të sëmurët, ushqimet, bukën, verën dhe të njëjtat gjëra kërkon që t'i bëjnë edhe nxënësit e tij: të bekojnë dhe të sjellin paqe në çdo shtëpi që shkojnë (krhs. Lk 10, 5-11). Si në famullitë tona në Kosovë, po ashtu edhe në Misionet që kemi në vende të ndryshme të botës, tradita e krishterë e bekimit të shtëpive vazhdon dhe është jashtëzakonisht e mirëpritur nga besimtarët, veçanërisht nga fëmijët. Prandaj, i ftojme prindërit dhe gjithë familjarët që të përgatiten sa më mirë për këtë takim, të gëzohen që ministri i Hyjit, meshtari, kalon në shtëpitë e tyre duke u lutur me ta dhe duke ndarë bekimin e Zotit. Do të ishte bukur nëse, çdo familje do të përgatiste një tavolinë duke e mbuluar atë me mbulesë të bardhë dhe duke vendosur mbi të ujin e bekuar, kryqin dhe Biblën, simbole këto që shprehin praninë e Zotit në familjen tonë, por edhe dashurinë dhe respektin që familjet kanë për Zotin dhe Fjalën e Tij.

Ta falënderojmë Hyjin për dhuratën e meshtarëve që vijnë për të bërë bekimin e familjes, sepse kjo është vërtetë një dhuratë e madhe që ju bëhet familjeve tona.

Festa gjallëron jetën

Të dashur lexues,

Përmes këtyre rreshtave dëshiroj të arrij në familjet tuaja me urimin më të mirë, që festa e Krishtlindjes të jetë për të gjithë një rast i mirë për të ripërtërirë dashurinë tonë për Zotin dhe për njëri-tjetrin.

Festa e Krishtlindjes, më shumë dhe më mirë se çdo festë tjetër, prek botën tonë njerëzore – emocionale. Hyji, në personin e Jezusit, bëhet njeri. Kjo është me të vërtetë një ngjarje e madhe, unike, e mrekullueshme dhe e papërsëritshme.

Ngjarja historike e lindjes së Jezu Krishtit, e ndodhur para dymijë viteve në qytetin e vogël të Betlehemit, është dëshmia më e madhe se Zoti nuk ka hequr dorë nga njeriu, pavarësisht pabesive të tija. Pikërisht për këtë arsye, njëra ndër ndjenjat që do duhej ta karakterizonte festën apo kremtimin tonë, është mbi të gjitha ndjenja e falënderimit.

Falënderim, para se gjithash, ndaj Hyjit që na ka krijuar në përngjasimin e tij, të aftë për të hyrë në marrëdhënie. Ai ka bërë me ne njerëzit një besëlidhje të përhershme dashurie. Na ka falur sa herë që ne e kemi tradhtuar dashurinë e tij. Ka ardhur në realitetin tonë të brishtë njerëzorë për të na shëruar dhe për të na pajtuar me Atin dhe me njëri-tjetrin. Na ka dëshmuar se ne të gjithë i përkasim Mbretërisë së tij. Na ka bërë pjesëtarë të misionit të tij duke na dhuruar Shpirtin Shenjt mbrojtës dhe të gjitha dhuratat e tija. Ka vdekur dhe është ringjallur, në mënyrë që edhe ne të jetojmë me Të për amshim.

Ndjenja e falënderimit do duhej të shtrihet edhe në marrëdhëniet tona ndërnjerëzore. Falënderim i përhershëm ndaj dashurisë dhe sakrificës së prindërve të cilët kanë pranuar të na lindin, rrisin dhe edukojnë në fe. Falënderim vëllezërve dhe motrave të cilët, në mënyrë të natyrshme, na kanë ndihmuar të bashkëndajmë çastet e mira dhe ato të vështira të jetës. Falënderim familjes që na ka edukuar të jetojmë si vëllezër dhe motra me njëri-tjetrin. Falënderim Kishës që edhe në kohët më të errëta dhe më të vështira të historisë tonë kombëtare, familjare dhe personale na ka qëndruar pranë duke kultivuar virtytin e dashurisë, të shpresës dhe të besës. Falënderim të gjithë atyre që i kemi takuar në udhëtimin tonë të jetës sepse i kanë dhënë kuptim dhe shkëlqim jetës tonë. Falënderim edhe atyre që na kanë bërë keq, sepse na kanë dhënë mundësi të japim dëshmi se më të vërtetë i takojmë Mbretërisë së Krishtit që është mbretëri falje, mirësie dhe dashurie.

Tendenca e mentalitetit të sotëm që festat të reduktohen në interes vetëm komercial duke i profanizuar ato, është një sfidë e madhe për besimin dhe kulturën e krishterë. Mjerisht, pre apo viktimitë e këtij mentaliteti, nganjëherë, jemi edhe ne të cilët besojmë në historinë e vërtetë të Jezusit. Kështu që, të gjithë, jemi të ftuar ta luftojmë dhe të fitojmë mbi këtë tendencë që synon të kënaqë vetëm dëshirat fizike, duke i anashkaluar ato shpirtërore.

Nëse festat e Krishtlindjes nuk e gjallërojnë jetën tonë (mendjen, shpirtin dhe trupin) në tërësi, ne mund të themi se kemi festuar Krishtlindjen, por, nuk do të mund të themi se shpirti ynë ka festuar dhe se është vërtetë i lumtur. Përkundrazi, të jetuarit e festave të Krishtlindjes pa Krishtin, do të shtojë në ne boshllëkun dhe pakënaqësinë tonë.

Të gjithëve ju uroj festën e Krishtlindjes, veçanërisht atyre që gjatë këtij viti, për arsye të vdekjes të më të dashurve të tyre, e kanë vështirë të festojnë, gjithsesi jemi të ftuar të besojmë se Jezusi është jetë, gëzim dhe ngushëllim për të gjithë!

Gëzuar Krishtlindjen dhe Vitin e Ri 2023!

Don Antoni



Përgatitja e festës është në njëfarë mënyre parashijim i saj. Në këtë mënyrë edhe ne stafi i ngushtë i Misionit tonë, së bashku me grupet e ndryshme egzistuese dhe me bashkëpunëtor të shumtë e kemi përjetuar përgatitjen dhe organizimin e mirë të festës tonë.

Fëmijët e Misionit, grupi i të rinjve, Forumi i Grave, Kori, Këshilltarët, vullnetarët e Misionit dhe bashkëpunëtorë të shumtë, të gjithë ishin të përfshirë në përgatitje dhe të caktuar në detyra të ndryshme, në mënyrë që festa jonë të jetë sa më madhështore.

Mbledhjet dhe takimet e shumta paraprake na ndihmuan që të organizohemi mirë dhe të koordinohemi me njëri-tjetrin.

Me 22 tetor kremtuam natën e festës së themelimit të 30-të të Misioni tonë. Paraditen e ditës së shtunë kremtuam Meshën e shenjtë, të cilën e udhëheqi mons. Dodë Gjergji, në bashkëkremtim me mons, Zef Gashin dhe meshtarët e pranishëm. Pas Meshës, Misioni ynë për miqtë e ardhur nga Kosova dhe Mali i

Zi, në restorantin Lux ka shtruar një drekë solemne, me ushqime dhe biseda të këndshme.

Pas kësaj dreke miqësore jemi kthyer në qendrën e Misionit tonë në Luzern, për të vazhduar me pjesën e akademisë festive.

Në akademi mori pjesë një numër i madh i të ftuarve që kishin ardhur nga vende të ndryshme të Evropës për të festuar së bashku me ne. Ambienti i bukur dhe larshmëria e programit bënë që të pranishmit të ndjeheshin vërtetë mirë dhe të gëzueshëm.

Fjalimet, ligjëratat, muzika, aktrimi dhe moderimi i programit bënë që kjo mbrëmje të ishte një mbrëmje të jashtëzakonshme për të gjithë të pranishmit.

Pas akademisë shkencore, të gjithë të pranishmit, u ftuan që të kalojnë në Kishë ku edhe u bë bekimi i trupores së Zojës së Lurdit, e cila zyrtarisht u vendos në Kishën e madhe të qendrës tonë.

Pas bekimit të trupores së Zojës, në ambientin e jashtëm të Kishës, ishte përgatitutr një apero, me pije dhe ushqime të shijshme, për të

gjithë të pranishmit. Festa e vigjiles së festës, miqësisht dhe vëllazërisht, zgjati deri në orët e vona të natës.

Të nesërmen, pra me 23 tetor, në sallën e madhe të qytetit në Sursee, në praninë e rreth 2000 të pranishmëve, është kremtuar Mesha e shenjtë, u mbajt programi kulturor dhe apero për të gjithë të pranishmit.

Meshën e shenjtë e ka udhëhequr ipeshkvi i Kosovës, mons. Dodë Gjergji, në bashkëkremtim me mons. Rrok Gjonlleshaj, arqipeshkëv i Tivarit, me mons. Zef Gashi, ipeshkëv në pension dhe me shumë meshtarë që kishin ardhur nga Kosova dhe pjesë të ndryshme të Zvicrës për të kremtuar së bashku me ne.

Kremtimi ishte solemn edhe falë ambientit të mirë dhe të bukur, ministrantave të shumtë, këndimit të korit tonë dhe koreve nga Sirnach-u dhe Arau, të udhëhequr nga motrat e nderit që shërbejnë në Misionet tona. Po ashtu edhe grupi i të rinjve, Këshilltarët dhe Forumi i Grave,

të veshur në uniformë, me organizimin dhe koordinimin e tyre në shërbim, i dhanë solemnitet kremtimit të kësaj feste.

Në mbarim të Meshës, mons. Zef Gashi lexoi bekimin apostolik që ati i shenjtë Papa Françesku i ka dërguar Misionit tonë me rastin e kremtimit të 30-të vjetorit të themelimit.

Në të njëjtin ambient, pas Meshës së shenjtë u mbajt programi i lamirshëm kulturor dhe artistik, që më këngë, recitime dhe valle shqiptare krijuan një atmosferë të mrekullueshme. Në këtë program morën pjesë: Fëmijët e Misionit tonë të Luzernit, Shkurte Fejza, këngëtare e mirënjohur e këngëve popullore shqiptare, zotëri Çun Lajçi, aktor i mirënjohur nga Kosova, zotëri Kristë Lleshi, me këngën kushtuar shën Nënë Terezës, Ansambli folklorik "Arbëresha" prej Sirnach-ut. Të gjithë së bashku krijuan një një atëmosferë mbresëlënëse duke na dhuruar emocione shumë të mira, të cilat do të mbeten gjatë në kujtesën e të pranishmëve.

Pas programit ishte aperoja e përgatitur nga Forumi i Grave dhe vullnetarët e shumtë. Ushqimet ishin kryesisht specialitete tona shqiptare, të përgatitura me shumë kujdes dhe dashuri nga familjet e besimtarëve tanë. Në këtë apero ka kontribuar edhe restoranti Rina-grill dhe firma e Nikollë Nokaj që me ushqimet e mira dhe kafet e shijshme shërbyen të pranishmit.

Angazhimi i Këshillit të Misionit, i Forumit të Grave, i grupit të të rinjve të Misionit, i donatorëve të shumtë dhe i shumë personave të tjerë vullnetarë, bënë që festa të kalojë mirë dhe qetë.

Falënderimi i takon Zotit i cili na ndihmoi dhe na bekoji me hire dhe përjetime të bukura, si gjatë përgatitjes, po ashtu edhe në ditët e kremtimit. Po ashtu një falënderim i përzemërt shkon edhe për secilin person që më praninë, dëshminë dhe kontributin e tij, ka bërë që festa të jetë vërtetë madheshtore.



(Foto: Werner Mathis)

Shkruan: m. Vida Ademi



(Foto: nga Arkivi)

Falë grupit të vullnetarëve të rinjve që është krijuar për 30-të vjetorin e Misionit tonë, kemi pasur mundësinë të njihemi me disa të rinj dhe të reja të Misionit dhe të ribashkohemi përsëri me disa ish-anëtarë të grupit tonë të vjetër të "Ansambllit Shqiponja".

Duke biseduar me Dianen për kohën kur kishim grupin, duke kujtuar se sa qaste të bukura kemi kaluar dhe sa kujtime të bukura kemi nga ajo kohë, vendosëm ta rikthejmë përsëri

grupin e vallëzimit "Shqiponja", sepse ne besojmë se brenda këtij grupi ka pasur dhe do të ketë vlera të mëdha miqësore, kombëtare dhe kulturore.

Përpos vallëzimit, për ne, është shumë me rëndësi edhe takimi me njëri-tjetrin, sepse kështu mund ta fisnikërojmë miqësinë tonë dhe njëkohësisht të ruajmë kulturën tonë shqiptare dhe ta përcjellim atë brez pas brezi.

Deri më tani jemi 30-të anëtarë të rinj dhe të reja që kemi filluar me prova të përbashkëta javore. Provat i kemi çdo të enjte duke filluar nga ora 19:30 tek qendra e Misionit tonë në Luzern.

Ne si grup besojmë me këmbëngulje në këto qëllime dhe do të punojmë që grupi i valltarëve të konsolidohet, të rritet në numër, të jetë gjithëpërfshirës dhe kështu ta përfaqësojë në mënyrë të denjë Misionin, kulturën dhe traditën tonë të lashtë shqiptare. Kështu që çdo anëtarë i ri është i mirëseardhur.



(Foto: Don Anton Uka)

Shkruan: Denisa Merturi, Sursee



FESTA E SHËN NIKOLLËS NË MISIONIN TONË

(Foto: Don Anton Uka)

Festat e dhjetorit i përjetojmë ndryshe për vetë faktin se kremtohen në kohë vjetore të veçantë por sidomos sepse kujtojmë dhe kremtojmë ngjarje vërtetë të bukura që kanë lënë shenja të pashlyeshme në historinë e njerëzimit.

Në fillimin e kohës së Ardhjes, kalendari kishtar kremton festën e Shën Nikollës, një

festë kjo shumë e dashur për fëmijët dhe e pranueshme edhe nga bota laike dhe nga ajo jo e krishterë. Menjëherë pas saj kalendari kremton festën e Zojës së Papërlyer, e njohur në popull si “Motra e Shën Nikollës”, pikërisht për arsye ajo është afër festës së Shën Nikollës por edhe për faktin se ky shenjt mendohet të ketë pasur një nderim dhe dashuri të madhe për Zojën e Bekuar.

Edhe në Misionin tonë këto festa shënohen me aktivitete të ndryshme shpirtërore dhe kulturore. Natën e Shën Nikollës kremtuam Meshën e shenjte, po ashtu edhe ditën e festës. Ndërsa, me 8 dhjetor, në praninë e një numri të madh fëmijësh dhe prindërve të tyre, kremtuam Meshën e shenjtë ku menjëherë pas Meshe kishim edhe programin argëtues dhe ndarjen e dhuratave për fëmijët.

Ishin vërtetë çaste të bukura për fëmijët dhe për gjithë të pranishmit.



(Foto: Gjonita Lleshdedaj)

Shkruan: Redaksia



KOHA E ARDHJES

(Foto: Nue Tuga)

Atmosfera e brendshme shpirtërore e cila krijohet para festave të Krishtlindjes, e bën vërtetë të veçantë dhe shumë të këndshme kohën e shenjtë të Ardhjes. Përgatitja e jashtme (dekorimi i ambienteve, rregullimi i bredhit, ndreqja e Betlehemit, gatimi i ushqimeve të Krishtlindjes), po ashtu edhe ajo shpirtërore (pjesëmarrja në Meshën e shenjtë, rrëfimi dhe njetet e ndryshme) i japin një përjetim ndryshe dhe krejt origjinal kohës së Ardhjes.

Edhe në Misionin tonë, përmes propozimeve dhe formave të ndryshme, mundohemi ta jetojmë sa më mirë dhe shenjtërisht këtë kohë të vitit liturgjik.

Përveç ripërtëritjeve shpirtërore me grupet e ndryshme të Misionit, besimtarëve tanë ju propozohet edhe pjesëmarrja në Meshët e mëngjesit apo Meshët rorate, si shenjë e pritjes tonë me fe, shpresë dhe dashuri ndaj Krishtit që vjen.

Përvoja e meshës së agimit mendohet të ketë lindur rreth shekullit të XV-të, pra pas Koncilit të Kalcedonit, kur është shpallur dogma e Marisë

Hyllindëse dhe kështu ka filluar të përhapet nëpër vende të ndryshme të botës. Në fillim Mesha e herëshme e agimit është kremtur për nder të Marisë Virgjër dhe janë kremtuar të shtunën, ditë ku virgjëra Mari nderohet në mënyrë të veçantë dhe më pas Roratet kanë filluar të kremtohen edhe ditëve të tjera.

Meshët e hershme të agimit mund të themi se simbolizojnë të qëndruarit zgjuar të krishterëve gjatë përgatitjes për Krishtlindje. Të krishterët janë të ftuar të qëndrojnë zgjuar mbi jetën e tyre që të jenë gjithmonë të gatshëm për takim me Krishtin, ashtu sikurse na mëson Jezusi “Rrini zgjuar; sepse nuk dini se në ç’ditë do të vijë Zotëria juaj!” (Mt 24, 42). Pas Meshës së shenjtë, të gjithë të pranishmit ftohen për kafën e mëngjesit dhe një agape të përbashkët. Përveç kësaj përvoje të bukur feje dhe vëllazërie, gjatë Kohës së Ardhjes, Kisha na fton që edhe përmes sakramentit të rrëfimit t’i përgatisim zemrat tona për takim me Krishtin që po vjen.

Shkruan: Redaksia

Festa familjare e Krishtlindjes

Në Misionin tonë, prej shumë vitesh tashmë, është bërë traditë që në nder të festës së Krishtlindjes të organizohet festa familjare. Viteve të fundit, për arsye të pandemisë, këtë festë nuk kemi mundur ta organizojmë, por tani që pandemia duket se ka kaluar po i rikthehemi kësaj përvoje të mirë festive.

Këtë vit festa familjare do të bëhet me 26

dhjetor, duke filluar nga ora 18:30, në qendrën italiane Papa Giovanni, në Emmenbrücke.

Kapaciteti i sallës është i limituar, prandaj nuk do të mundemi të pranojmë më shumë se 400 persona. Çmimi për persona të rritur është 40.- franga, ndërsa për fëmijët deri në moshën 12-të vjeçare, 20.- franga. Ky çmim përfshinë darkën dhe muzikën, ndërsa pijet alkoolike nuk janë të përfshira në këtë çmim.



(Foto: Luljeta Bisaku)

AKTIVITET BAMIRËSIE

Kisha Katolike, në historinë e saj dymijë vjeçare, krahas dashurisë dhe shërbesës ndaj Hyjit ka pasur dhe vazhdon të ketë një kujdes apo dashuri të veçantë edhe ndaj njerëzve, veçanërisht ndaj atyre në nevojë. Kjo mënyrë e të jetuarit të fesë është mishërimi i urdhërimit të dashurisë me anë të të cilit vetë Jezusi na mëson dhe na edukon ta duam Hyjin dhe njëri-tjetrin, si vetveten.

Gjatë vitit, veçanërisht në kohën e Kreshmëve dhe atë të Ardhjes, ne si bashkësi e krishterë organizohemi dhe mundohemi që konkretisht të bëjmë diçka për ata që trokasin dhe kërkojnë ndihmë nga ne.



(Foto: m. Mrika Sabedini)

Ne, Forumi i Grave të Misionit tonë në Luzern, në bashkëpunim me Motrat e nderit, mbrëmjen e 7-të dhjetorit jemi bashkuar në ambientet e qendrës tonë në Luzern dhe bashkarisht kemi përgatitur pakon e ëmbëlsirave të cilat do të shitën, dhe paratë e mbledhura do të dërgohen për të varfër dhe të sëmurë.

Këto përvoja janë vërtetë të veçanta, jo vetëm për faktin se kushtojmë kohë, punë dhe gjëra materiale, por, mbi të gjitha për faktin se kështu mund të qëndrojmë së bashku, të bisedojmë dhe të kënaqemi në praninë e njëra-tjetrës.

Përveç aktiviteteve të bamirësisë, ne si Forum i Grave organizojmë edhe aktivitete të tjera kulturore dhe shpirtërore. Është gjithmonë kënaqësi kur ne, me praninë dhe me punën tonë, ja dalim të bëjmë diçka të mirë dhe të dobishme për të tjerët.

Urojmë që ne, Forumi i Grave, të mos ndalemi asnjëherë, përkundrazi, jemi të ftuara ta zgjerojmë numrin dhe aktivitetin tonë, prandaj edhe i ftojme të gjitha ato gra dhe nëna, të cilat kanë kohë dhe dëshirë, të na bashkangjiten dhe kështu bashkarisht, në shembullin e Nënës tonë Tereze, të bëjmë gjëra të vogla, por me dashuri të madhe.

Shkruan: Gjonita Lleshdedaj, Kriens



Të shtunën, më 10-të dhjetor, Misioni ynë në Luzern ka organizuar darkën e falënderimit për të gjithë bashkëpunëtorët dhe bashkëpunëtorët e vet.

Fillimisht kjo darkë shtruhej vetëm për përcjellësit e bekimit të shtëpive, ndërsa tani, prej dy vitesh, stafi i ngushtë i Misionit ka vendosur që në fund të vitit të shtrohet një darkë falënderimi në të cilën ftohen të gjithë ata persona, që në forma dhe aktivitete të ndryshme ndihmojnë ecurinë e punës në Mision. Bashkëpunëtorët janë të ftuar të vijnë në shoqërimin e bashkëshortes apo të bashkëshortit.

Këtë vit mbrëmja ishte më të vërtetë festive dhe shumë solemne. Kjo vërehej nga rregullimi i sallës. Mbulesa e tavolinave me çarçafë të bardhë mëndafshi dhe ngjyra krishtlindjeje. Dekorimi me lule dhe qirinj. Renditja e tavolinave në formë sofre, pra gjithçka ishte e bërë me shije që jepte përshtypjen e një feste familjare.

Para se të akomodoheshim në vendet e përgatitura, në hollin e sallës së madhe ishte përgatitur një koktej ku të pranishmit patën mundësi të shërbeheshin me pije dhe njëkohësisht të përshëndeteshin me njëri-tjetrin. Pastaj, të pranishmit u vendosën në sallën e madhe dhe filloi darka me fjalën përshëndetëse nga i zoti i shtëpisë don Anton Uka. Misionari ynë kishte përgatitur një fjalim, ku mes të tjerave, theksoi se: “Ngjarja historike e lindjes së Jezu Krishtit,

e ndodhur para dymijë viteve në qytetin e vogël të Betlehemit, është dëshmia më e madhe se Zoti nuk ka hequr dorë nga njeriu, pavarësisht pabesive të tija. Pikërisht për këtë arsye, njëra ndër ndjenjat që do duhej ta karakterizonte festën apo kremtimin tonë, është mbi të gjitha ndjenja e falënderimit”.

Don Antoni theksoi se jemi të ftuar ta falënderojmë Hyjin dhe njëri-tjetrin, kjo ishte edhe arsyeja që përmes kësaj darke t’i themi faleminderit Zotit dhe të gjithë atyre personave që me punën dhe kontributin e tyre ndihmojnë në Misionin tonë.

Pas fjalës përshëndetëse dhe lutjes së bekimit, filloi festa me këngë të bukura qytetare dhe popullore të kënduara nga miqtë tanë këngëtarë Afërdita Krasniqi, Shpejtim dhe Bashkim Krasniqi, të cilët, enkas për ne, kishin ardhur nga qyteti i Gjenevës.

Mbrëmja, përveç pijeve dhe ushqimeve të shijshme, të përgatitura nga Nikollë dhe Violeta Markaj, kishte edhe program të pasur kulturor dhe argëtues. Fjalimet e ndryshme, lojërat e përgatitura, humori dhe shakatë e mira e bënë këtë mbrëmje vërtetë të veçantë dhe shumë familjare.

Mbrëmja u përmbyll me urime dhe përgëzime për një festim sa më të mirë të Krishtlindjes dhe shumë të mira e bekime për Vitin e Ri 2023.

Shkruan: Valentina Prenrecaj, Root



Ambasada e Shqipërisë në Zvicër, me 28 nëntor, ka organizuar pritje solemne në nder të festës së 110-të vjetorit të pavarësisë së Shqipërisë, e njohur ndryshe edhe si festa e Flamurit kombëtar.

Në këtë mbrëmje festive ishin të ftuar ambasadorë të shumtë, si edhe përfaqësues të institucioneve të ndryshme në Zvicër, në mesin e tyre edhe Misioni ynë në Luzern, i përfaqësuar nga don Anton Uka. Pas mirëpritjes së të ftuarve nga ambasadori nikoqir, zotëri Ilir

Gjoni, festa filloi me këndimin e himnit të Shqipërisë dhe atë të Zvicrës. Pastaj, ambasadori Gjoni, përmes fjalës së rastit, përshëndeti të pranishmit duke përçuar mesazh mirënjohje dhe falënderimi me rastin e festës së pavarësisë së Shqipërisë.

Ambasadori Gjoni falënderoi don Antonin për pjesëmarrje në festë duke uruar që takimet e tilla të jeni nxitje për një mbështetje dhe bashkëpunim edhe më të thellë.

Shkruan: Redaksia

Ripërtëritje shpirtërore për fëmijë

Më 26 nëntor në agjendën e Misionit tonë ishte e paraparë ripërtëritja shpirtërore për fëmijët e katekizmit dhe ministrantat tanë. Takimin e udhëhoqi don Antoni i cili fëmijëve ju tregoi domethënien e kohës së Ardhjes, si dhe ju



(Foto: m. Mrika Sabedini)

shpjegoi kuptimin e simboleve të Krishtlindjes.

Më pas fëmijët vazhduan me pyetje të shumta dhe më tregimin e tyre mbi Krishtlindjen. Disa prej tyre arritën të tregojnë shumë bukur historinë e lindjes së Jezusit në Betlehem si dhe simbolet e shpellës së Betlehemit.

Pas takimit, fëmijët kanë pasur mundësinë të qëndrojnë së bashku, të luajnë dhe të qëndrojnë në shoqërinë e njërit-tjetrit, ndërkohë që prindërit patën mundësi të qëndrojnë së bashku dhe të shkëmbejnë mendimet e tyre.

Edhe kjo ishte një përvojë e bukur dhe e këndshme për të gjithë të pranishmit. Urojmë që edhe këto momente të shërbejnë për rritjen dhe formimin e fëmijëve tanë.

Shkruan: Redaksia



(Foto: Werner Mathis)

FJALIMI I MONS. DODË GJERGJIT, IPESHKËV I KOSOVËS

Të dashur zonja dhe zotërinj, mirëmbërëma! Gëzohem që jam në mesin tuaj dhe me juve të festoj këtë Jubile të 30-vjetorit të Misionit tonë këtu në Luzern.

Dëshiroj të përshëndes kryetarin e qytetit të Luzernit, zotëri Beat Züsli; mons Rrok Gjonlleshaj, arqipeshkëv i Tivarit; mons. Zef Gashin; ambasadorin e Maqedonisë, të Kosovës dhe të Shqipërisë dhe gjithë ju të pranishëm.

Përzemërsisht ju them: Mirë se keni ardhur!

Nuk është hera e parë që njerëzit tanë kanë krenuar dhe kanë folur në Misionin tonë, kujtoj njerëzit që kishin ardhur prej vendeve të ndryshme për të krenuar 25-vjetorin e Misionit.

Në këtë moment përkujtimi dhe feste i kujtojmë njerëzit që kanë punuar punë shumë të rënda, ndërsa tani kemi të rinj që i bien pianos, violinës dhe kanë arritje të shumta në lami të ndryshme. Unë kujtoj kur isha fëmijë, kur kemi festuar në familjen time festat e shtëpisë, nëna jonë vendin e babait e linte gjithmonë të zbrazët për të kujtuar dhe për të mos harruar se babai nuk është i pranishëm në shtëpi dhe është diku duke punuar për ne. Mjerisht tani është e gjithë tavolina e zbrazët dhe askush nuk është në

shtëpi. Shumë familje anëtarët e tyre i kanë sjellë këtu. Do të ishte mirë që mos të harrojmë kurrë se anëtarët tjerë që janë në Kosovë ose diku tjetër ndjejnë mungesën tuaj.

Jam krenar që njerëzit tanë që jetojnë këtu, janë integruar mirë e shpejt, veçanërisht katolikët në Kishën katolike janë integruar dhe janë katolik të mirë, por nuk them se janë më të mirët, por të mirë. Njerëzit tanë janë edhe qytetarë të mirë dhe Zvicrën e kanë si atdhe të dytë të tyre, punojnë me gjithë forcë dhe me zemër për familje dhe për të mirën e këtij vendi.

Disa ndoshta kujtojnë padrejtësitë që në atdheun e tyre kanë përjetuar përmes regjimeve të ndryshme, por tani kanë një të ardhme më të mirë për vete dhe për familjet e tyre. Nga ana tjetër jam shumë falënderues që njerëzit tanë kurrë nuk e kanë harruar atdheun dhe kishën e tyre, dhe thënie që ne kemi për Fe e Atdhe.

Faleminderit që na nderoni me veprën tuaj të mirë, me familjet tuaja të shenjta dhe me punën tuaj të ndershme.

Urime e festofshi qindra vite, por mos harroni se gjithmonë do të jeni shqiptar dhe vetëm si të tillë do të shkëlqeni më mirë.



Sehr geehrte Festgemeinde
 Als Vizepräsident des Administrativrates der Migrantenseelsorge der röm.-kath. Kirche des Kantons Luzern ist es mir eine Ehre, der Albaner-Mission zu ihrem 30-Jahr-Jubiläum zu gratulieren. Herzliche Grüsse übermittle ich Ihnen besonders auch im Namen des Administrativrates und der Geschäftsführung der Migrantenseelsorge.

Der Administrativrat der Migrantenseelsorge nimmt die Albaner-Mission als aktive und lebendige Mission wahr. Sie hat ihren pastoralen

Hauptstandort hier an der Rodteggstrasse im St. Michael in Luzern. Die Albanische Mission betreut regional ca. 5000 Familien. Zu ihren Schwerpunkten gehören die wöchentlichen Gottesdienste an verschiedenen Standorten bis in Wallis und ins Tessin und die diakonische Betreuung der Gläubigen. Ich möchte betont haben, dass die Albaner-Mission mit ihrer Art und Weise für eine willkommene Kulturvielfalt in der Schweiz sorgt.

Damit die Albaner-Mission weiterhin ihre pastoralen Dienstleistungen tätigen kann, verdanken wir einerseits den Luzerner Kirchgemeinden sowie den Beiträgen der Nachbarkantone und andererseits den Quellensteuererträgen. Der Administrativrat setzt alles daran, dass die finanzielle Situation weiterhin so gut ist, dies zum Wohle aller Missionen der Migrantenseelsorge. Nun wünsche ich Ihnen allen eine wunderbare Feier und nur das Beste für die Zukunft der Albaner-Mission.

Vielen Dank.



(Foto: Frrrok Kolaj)

Thomas Huber

DIE SRF-REPORTAGE ÜBER UNSERE MISSION

INTERVIEWER: RAPHAEL ZEHNDER, REDAKTOR KULTUR UND GESELLSCHAFT SRF 2 KULTUR



Seit 30 Jahren existiert nun die «Misioni Katolik Shqiptar». Ein wichtiger Ankerpunkt für die katholischen Albanerinnen und Albaner in der Schweiz. Raphael Zehnder von SRF hat im September unseren Gottesdienst in der St. Georg Kirche in Sursee besucht und anschliessend Don Anton und einige Gläubige interviewt.

Welches sind Ihre Aufgaben als Pfarrer in der albanischen Mission?

Don Anton Uka: Es ist nicht nur eine Aufgabe. Es ist eine Mission dem Volk zu dienen und somit auch Gott zu dienen.

Wie sieht Ihr Tagesablauf aus?

Don Anton Uka: Die Aufgaben sind verschiedenen. Meditieren, beten, lesen und das Selbststudium gehören zu den persönlichen Aufgaben. Die Gläubigen in Spitälern oder zu Hause besuchen und/oder diese in der Pfarrei zu empfangen bei Krankheit, Hilfe und Sorgen gehören zu den pastoralen Aufgaben. Zum Schluss gibt es dann noch die administrativen Aufgaben.

Was sind die grössten Freuden und Sorgen der Gemeindemitglieder?

Don Anton Uka: Ganz verschieden! So wie die Menschen individuell sind, so sind auch ihre Freuden und Sorgen individuell. Eine der Sorgen, die erwähnt werden kann, ist das Aufeinandertreffen der Generationen. Die erste Generation, die stark mit der Heimat verbunden ist, und die zweite Generation die hier in der Schweiz aufgewachsen ist. Dass hier eine gute Zusammenarbeit und Harmonie geschaffen wird.

Freuden gibt es viele! Wir sind ein Volk, das sich über Kleinigkeiten freut. Der Erfolg der eigenen Kinder. Eine gelungene Integration. Eine gesunde Familie. Es sind die kleinen Sachen, die uns erfreuen.

Die Christinnen und Christen sind eine Minderheit in der albanischen Gemeinschaft. Wie steht es zum Verhältnis der christlichen Minderheit und der muslimischen Mehrheit?

Don Anton Uka: Das was unser Volk ausmacht ist, dass wir uns in erster Linie als Albanerinnen und Albaner sehen. Die Nation wird vor die Religion und vor den Glauben gestellt. Diese Besonderheit macht unseren Zusammenhalt aus. Durch unsere gemeinsame Geschichte und Kultur sind wir miteinander verbunden. In unserer Mission sind alle willkommen und jeder soll sich wohlfühlen.

Was wünschen Sie sich für Ihre Gläubigen?

Don Anton Uka: Jedes Volk und jede Kultur kann etwas zur Gesellschaft beitragen. Wir können alle voneinander lernen und so ein gutes Zusammenleben schaffen. Daher wünsche ich mir, dass unser albanisches Volk sich gut integriert und dennoch seine Identität bewahrt.

Warum nehmen Sie an der Messe teil?

Lorena Lleshdedaj: Mir ist der Glaube und die Religion sehr wichtig. Es ist mir wichtig, dass ich viel Kontakt zu Gott habe.

Wieso albanisch und nicht deutsch?

Lorena Lleshdedaj: Meine Eltern sind beide ursprünglich aus Kosovë, daher nehme ich an der albanischen Messe teil. Ich könnte auch an einer deutschen Messe teilnehmen, was ich auch schon gemacht habe, meine Erstkommu-

nion habe ich in einer deutschen Messe gefeiert. Jedoch gehe ich von klein auf in die albanische Messe und daher kommt es hier mehr von Herzen, da ich mit diesen Menschen aufgewachsen bin.

Warum nehmen Sie an der albanischen Messe teil?

Simon Rosaj: Mir ist der Glaube wichtig. Wir leben in einer hektischen Welt, in einer hektischen Zeit. Ich ertappe mich immer wieder dabei, wie gut ich mich nach einem Besuch in der Kirche fühle – da ich Zeit hatte in mich zu kehren.

Ist es für Sie wichtig, dass Sie dies in der albanischen Sprache machen?

Simon Rosaj: Nein, für mich spielt das keine Rolle. Ich kann das auch auf Deutsch, da ich hier geboren und aufgewachsen bin. Für mich ist das eine Zugehörigkeit. Ich bin von klein auf in die albanische Messe gegangen und daher zieht es mich immer wieder in die albanische Messe.

Was mögen Sie am liebsten an den Anlässen der albanischen Mission?

Simon Rosaj: Die Mission gibt es seit 30 Jahren. Es ist eine grosse Familie daraus entstanden. Freundschaften sind durch die Mission entstanden.

Was sind Ihre Aufgaben in der Mission?

Diana Prenrecaj: Als Kind habe ich ministriert und heute bin ich Lektorin.

Wieso ist für die albanische Gemeinschaft zur Heimat geworden?

Diana Prenrecaj: Ich gehöre von klein auf zur Gemeinschaft und habe immer die albanische Messe besucht.

Spielt es für Sie eine Rolle, in welcher Sprache Sie die Messe besuchen?

Diana Prenrecaj: Nein, ich besuche auch die deutsche Messe und fühle mich in beiden Sprachen sehr wohl.

Welches sind Ihre Aufgaben in der Mission?

Toni Tuqi: Ich bin im Kirchenrat.

Wie kam es dazu, dass Sie sich hier engagiert haben?

Toni Tuqi: Ich bin seit dem ersten Tag in der Mission engagiert. Seit der Gründung 1992.

Waren Sie schon im Kosovo an der Religion interessiert?

Toni Tuqi: Da ich der einzige Christ in der Schule war, wurde ich immer mit diesem Thema konfrontiert. Durch meinen christlichen Namen haben immer alle gewusst, dass ich Christ bin.

Hatten Sie Probleme deswegen?

Toni Tuqi: Nein, ich hatte keine Probleme. Wir sprechen alle die gleiche Sprache, haben die gleiche Kultur, essen das gleiche Essen. Es gab nie Probleme diesbezüglich.

Was bedeutet für Sie die albanische Mission?

Toni Tuqi: Es ist ein Ort der Ruhe! Ein Stückchen Heimat!

Was meinen Sie mit Heimat? Was bedeutet das für Sie?

Toni Tuqi: Ich bin mit 26 Jahren in die Schweiz gekommen und mir hat etwas gefehlt. Ich habe mich daher seit dem ersten Tag in der Mission engagiert, so hatte ich das Gefühl es ist wie ein Stückchen Heimat.

(Das Interview wurde durch Diana Prenrecaj schriftlich zusammengefasst)



(Foto: Ffrok Kola)

DIE REDE DES STADTPRÄSIDENTEN

Meine sehr verehrten Damen und Herren, liebe Luzernerinnen und Luzerner! Vielen herzlichen Dank, dass Sie mich zu Ihrem Jubiläumsanlass eingeladen haben. 30 Jahre Albanische Katholische Mission in Luzern, das ist eine stolze Zahl! Seit 3 Jahrzehnten treffen Sie sich, um gemeinsam den Glauben so zu leben, wie Sie ihn aus Ihrem Heimatland kennen. Auch wenn für viele – oder für die meisten – von Ihnen Luzern und die Schweiz längst Heimat geworden sind.

Ich bin Stadtpräsident von Luzern, Ihrer Heimatstadt. Stadtpräsident bedeutet, dass ich der Stadtregierung vorstehe. Aber ich regiere die Stadt nicht – nicht alleine. Ich bin einer von fünf Gleichberechtigten. Um Entscheidungen herbeizuführen ringe ich täglich um Mehrheiten; weil es nötig ist, für Ideen, für Projekte, für Ausgaben eine tragfähige Mehrheit zu finden.

So erlebe ich es täglich, zu einer Minderheit zu gehören, obschon ich an einer so genannten «Machtposition» sitze. Meine Partei, die SP, stellt zwar die meisten Mitglieder im Parlament. Aber eben bloss rund einen Viertel. Wenn ich mich für

das Theater einsetze, so engagiere ich mich für eine Minderheit. Die wenigsten Luzernerinnen und Luzerner besuchen das Theater regelmässig. Dennoch wünscht sich die Mehrheit der Bevölkerung ein attraktives Luzerner Theater. Wenn ich mich als Bildungsdirektor für gute Schulen einsetze, so engagiere ich mich für eine Minderheit. Nicht einmal in jedem 4. Haushalt in der Stadt Luzern leben Kinder. Wenn wir jedoch ein neues Schulhaus bauen, so erhalten wir an der Urne Mehrheiten von weit über 80 Prozent. Der Ausgleich zwischen Minderheiten und Mehrheiten ist in der Luzerner Stadtpolitik Normalität.

Das Zusammenleben verschiedener Menschen gelingt immer dann, wenn die Mehrheiten die Anliegen der Minderheiten achten. Eigentlich nur dann. Denn jede und jeder gehört immer wieder irgendwie einer Minderheit oder einer Mehrheit an.

Als Albanerinnen und Albaner sind Sie in Luzern eine kleine Minderheit. Die Mitglieder der katholischen Albanermision sind innerhalb der christlichen Gemeinschaften eine kleine Gruppe. Aber innerhalb der religiösen Men-

schen machen die Katholikinnen und Katholiken in Luzern die Mehrheit aus.

Das Zusammenleben mit anders glaubenden oder anders politisierenden Menschen, mit Menschen einer anderen Hautfarbe, eines anderen Geschlechts, einer anderen Herkunft bedarf immer einer gewissen Rücksichtnahme. (Weil aus meiner Sicht ja immer das andere «anders» ist. Aussergewöhnlich sind ja die anderen, nicht ich selbst.) Das kann anstrengend sein, sicherlich ist es lohnenswert. Wer Kinder hat, hat es schon erfahren: Das Zusammenleben von Alt und Jung kann durchaus herausfordernd sein, aber persönlich bereichernd. Die Beschäftigung mit einer anderen Religion oder Konfession beispielsweise eröffnet neue Perspektiven. Und gleichwohl leidet die Menschheit seit Jahrhunderten daran, Andersgläubige nicht als Bereicherung, sondern als Bedrohung zu sehen. Dasselbe gilt für Menschen einer anderen Ethnie, einer anderen Nationalität.

Dabei sprechen wir in der Regel von Integration, moderner Inklusion. Integration ist nicht einfach Assimilation und Anpassung, ebenso wenig ist es das blosse Nebeneinander unterschiedlicher Kulturen in ein und derselben Region beziehungsweise Gesellschaft. Integration ist vielmehr ein Prozess zwischen allen Men-

schen, die sich einen Lebensraum teilen. Integration in einer Gesellschaft ist dann erreicht, wenn möglichst alle ihre Mitglieder am sozialen, ökonomischen und politischen Leben gleichberechtigt teilhaben können, wenn sie teilnehmen und mitwirken dürfen. Das bedarf immer einer gewissen Anstrengung. Und es setzt den Willen voraus, Neues und Anderes nicht bloss zu akzeptieren, sondern es aufzunehmen. Also auch, Veränderung bei sich selbst zuzulassen. Egal ob man grad in der Position einer Mehrheit oder einer Minderheit ist.

Die Katholische Albanische Mission ermöglicht katholischen Albanerinnen und Albanern in Luzern, die Kultur und Religion der alten Heimat zu pflegen. Ohne sich verstecken zu müssen, ohne sich rechtfertigen zu müssen. Wir wissen, es gibt Gesellschaften, in denen das keinesfalls akzeptiert würde. Ich bin froh, versuchen wir in Luzern stets eine tolerante, offene, multikulturelle Gesellschaft zu leben. Vielen Dank, dass Sie Ihren Beitrag leisten. Indem Sie Ihre albanisch-katholischen Wurzeln pflegen und gleichzeitig den Austausch darüber hinaus suchen. So wie heute.

Vielen Dank, darf ich daran teilhaben.

Beat Züsli, Luzern



(Foto: Frrak Kolaj)



FJALA E KRYEMINISTRIT TË KOSOVËS

(Foto: Firok Kolaj)

I nderuari udhëheqës i Misionit Katolik Shqiptar në Luzern, Don Anton Uka, I nderuari ipeshkëv i Dioqezës Prizren – Prishtinë, Dodë Gjergji, I nderuar kryetar i komunës së Luzernit, z. Beat Züsli, I nderuar përfaqësues i Kishës vendore në Luzern, z. Cornelio Zraggen, Të nderuar të pranishëm, Zonja e zotërinj, Motra e vëllezër,

Kam kënaqësi të posaçme që të ndajë gëzimin me ju bashkë, sot, këtu, në tridhjetë vjetorin e Misionit Katolik Shqiptar në Zvicër. Për plot tri dekada ju predikuar dhe edukuar gjenerata të tëra, frymëzuar për paqe dhe bashkëjetesë, tridhjetë vite ofruar mirësi dhe orientim të drejtë për familjet shqiptare, për besimtarët që flasin dhe mendojnë shqip dhe e kanë familjen dhe shqiptarinë përkushtim e traditë.

Predikimi i trashëguar nga kolosët fetarë shqiptarë siç ishin Pjetër Bogdani, At Gjergj Fishta, Patër Shtejfën Gjeçovi, Don Lazër Mjeda e Patër Anton Harapi - ata e kishin binomin Fe dhe Atdhe synim e parim, mënyrë të jetesës dhe të jetës, që e mësonin, se kudo qofshin shqiptarët,

janë shqiptarë pa marrë parasysh juridiksionin administrativ, bindjet ideologjike, besimin, dialektin, larushinë folklorike etj.

Misionet katolike shqiptare janë vende ku ushqehet kultura shqiptare, ku njerëzit vijnë për të shkëmbyer informacione nga përditshmëria e përvoja nga jeta, ku njihen me njëri-tjetrin, bisedojnë bashkë, që të bashkëpunojnë dhe bashkëveprojnë. Dhe sigurisht, mesha e shenjtë, liturgjia dhe katekeza janë ato që i mbledhin ata së bashku, si ind lidhor për njerëzit tanë jashtë vendit.

Këshilli i dytë i Vatikanit në pikën 18 të dekretit Christus Dominus diskutoi gjithashtu për migrantët katolikë (të zhvendosurit dhe refugjatët...) ku thuhet: “Duhet të tregohet kujdes i veçantë për besimtarët, të cilët, për shkak të rrethanave të tyre të jetës, nuk janë në gjendje të përdorin sa duhet shërbimin e rregullt e të përgjithshëm pastoral të priftit të famullisë ose janë plotësisht pa të.”

Gjithçka që është thënë më parë rreth doku-

menteve të kishës, e gjithë kjo ishte dhe është në shërbim të ruajtjes së dinjitetit njerëzor, besimit katolik dhe identitetit kombëtar të emigrantëve shqiptarë. Kisha dëshiron së pari të ruajë me ta besimin që kanë thithur në atdheun e tyre me qumështin e gjirit të nënës, t'ua dorëzojë brezave të rinj që do të angazhohen në jetën fetare të atdheut të ri, duke kërkuar të ruajnë të gjitha format e tjera të trashëgimisë së tyre shpirtërore, domethënë, ashtu siç e thotë bukur Udhëzimi për kujdesin baritor për migrantët: «Migrantët mbajnë me vete mënyrën e tyre të menduarit, gjuhën e tyre, kulturën dhe fenë e tyre. E gjithë kjo përbën një trashëgimi shpirtërore dhe kulturore, e cila do të vazhdojë përtej atdheut. Kjo trashëgimi duhet marrë parasysh kudo. Duke vepruar kështu, gjuhës amtare i jepet vendi i duhur, nëpërmjet së cilës besimtarët shprehin mentalitetin, format e mendimit dhe kulturës dhe vetë karakterin e jetës së tyre identitare dhe shpirtërore”.

Këto fjalë të dokumentit të kishës justifikojnë veprimtarinë e gjallë të misioneve katolike shqiptare jo vetëm në fushën e fesë, por gjithashtu në



(Foto: Don Marjan Ukaj)

fushën më të gjerë të ruajtjes së gjuhës amtare dhe vlerave shpirtërore dhe identitetit kombëtar. Por është e qartë për kishën se ajo duhet t'i kushtojë shumë kohë ripërtëritjes shpirtërore të besimtarëve shqiptarë, të edukuar jashtë atdheut, jo vetëm që të jenë katolikë të mirë dhe freskues për Kishën në atdheun e tyre të ri, por të jenë shqiptarë të devotshëm që do të edukojnë familjen me tradita kombëtare dhe gjithashtu të shikojnë nga atdheu dhe të forcojnë lidhjet me të. Priftërinjtë e këtij misioni përkujdesen për besimtarët shqiptarë që jetojnë gjeografikisht larg atdheut të tyre, duke i përfshirë besimtarët shqiptarë, të besimit katolik që në familjet e tyre të kujdesen për traditat dhe trashëgiminë e të parëve të tyre. Sepse duke ushqyer rrënjët e tyre, ata kujdesen edhe për të ardhmen e tyre.

Roli i priftit në Misionin katolik shqiptar ishte i madh sepse me besimtarë të vetë dhe jo vetëm, ndanë fatin e njeriut tonë jashtë vendit dhe e ndihmuan atë të ruante fenë, gjuhën, identitetin, zakonet, kulturën dhe dinjitetin kombëtar.

Jezu Krishti është përmbajtja dhe përmbushja e premtimit, të cilën, çdo besimtar shqiptar i besimit katolik, e përjeton si besnikëri që përcakton marrëdhënien e tij me Hyun, prandaj marrëdhënia ndaj Zotit të çon gjithmonë në një marrëdhënie më të sinqertë me njeriun dhe si rrjedhojë me familjen, shtetin dhe kombin.

Shqiptarët, kudo qofshin ata, kanë gjetur dhe pranuar formulën për bashkëjetesën fetare, të cilën e kanë dalluar si veçori tonën, shtetet dhe kombet tjera. Kjo bashkëjetesë do të frymojnë për jetë e mot!

Gëzuar dhe festofshi gjithherë në familjet tuaja!

Albin Kurti
Kryeministër i Republikës së Kosovës

(Kryeministri i Kosovës, zotëri Albin Kurti, për arsye të obligimeve nuk ka mundur të merr pjesë në akademinë shkencore, por ai ka dërguar mesazhin e vetë të cilin e ka lexuar Nikollë Ukaj)



FJALË PËRSHËNDETËSE E NIKOQIRIT

Të nderuar ipeshkvij, meshtarë, motra të nderit, përfaqësues të Kishës vendore në Luzern, ligjërues, ambasador, këngëtarë, artistë, përfaqësues të shoqatave dhe institucioneve të ndryshme, përfaqësues të masme-diave, moderatorë të kësaj mbrëmje, besimtarë të Misionit Katolik Shqiptar në Luzern dhe ju të gjithë të pranishëm!

Kam nderin dhe kënaqësinë që në emër të Misioneve tona këtu në Zvicër t'ju përshëndes dhe t'ju falënderoj përzemërsisht për praninë tuaj në festën e 30-të vjetorit të themelimit të Misionit Katolik Shqiptar në Luzern. Një përshëndetje dhe falënderim i veçantë i shkon kryetarit të qytetit të Luzernit, zotërisë së nderuar Beat Züsi.

Misioni ynë në Luzern dhe pastaj edhe ai në Sirnach dhe Aarau, nga viti i themelimit e deri më sot, në krye me misionarët përgjegjës, me motrat e nderit dhe me bashkëpunëtorët e

ngushtë, ka qenë dhe vazhdon të jetë mis-hërues besnik i porosisë së Jezusit: "Dilni në mbarë botën e predikoni Ungjillin të gjithë njerëzve; gjatë udhëtimit shpallni: Mbretëria e qiellit është ngjat! ... Falas morët, falas edhe jepni!" (Mk 16, 15; Mt 10, 7-8). Këto fjalë të Jezusit, që përbëjnë kornizën më të bukur të thirrjes dhe të dërgimit në mision, vazhdojnë të mbesin frymëzim i shërbimit dhe i veprimit tonë.

Misionet tona në Zvicër, siç dihet, janë në shërbim të më shumë se 30-të mijë shqiptarëve të besimit katolik, të ardhur kryesisht nga Kosova. Vlen të theksohet se qendrat tona kanë qenë të hapura dhe kanë një kujdes e dashuri të veçantë ndaj të gjithë shqiptarëve që jetojnë në Zvicër, pa marrë parasysh përkatësinë fetare apo bindjen politike.

Veprimtaria jonë asnjëherë nuk ka qenë dhe nuk do të jetë e rezervuar vetëm për disa; pi-

kërisht se përmes saj përçojmë vlerat njerëzore dhe njëkohësisht i ruajmë traditat tona kulturore, fetare dhe kombëtare. Gatishmëria për t'i vizituar të sëmurët, për t'i ndihmuar nevojtarët, për të ndarë sakramentet, për të vizituar dhe bekuar familjet, për t'i ngushëlluar të pikëlluarit e për ta ndarë gëzimin së bashku, është njëra ndër karakteristikat më të bukura dhe më të shenjta të Misionit tonë.

Ne si misionarë jemi të vetëdijshëm se shëndeti i njeriut, i familjes, i shoqërisë, i komunitetit, i Kishës dhe i politikës varet kryesisht nga rrënjët e shëndosha. Prandaj me plot të drejtë thoshte filozofi i madh Viktor Hugo: "Bëni si pemët: ndërroni gjethet, por jo rrënjët. Pra, ndërroni idetë tuaja, por ruani parimet". Kjo është një sfidë e madhe për Misionin Katolik Shqiptar në Zvicër, për popullin tonë shqiptar dhe për civilizimin perëndimor në përgjithësi.

Ne, mërgata shqiptare e dekadave të fundit, do të bënim mirë sikur të merrnim për model mërgatën e kohës së Gjergj Kastriotit apo arbëreshët e sotëm. Ata i pëngjajnë një lisi shekullor, i cili me krenari harliset, sepse i ka rrënjët thellë në dhe. Ata rezistuan dhe e ruajtën identitetin ndër shekuj, sepse ishin të ankoruar në ideale fetare dhe kombëtare. Kush mbështetet në traditë, i përballon shtërngatave të kohës dhe rrezaton dashuri, kulturë dhe dije për të tjerët.

Ndërsa sot po përkujtojmë 30-të vite përvojë, shërbim dhe jetë të Misionit tonë, dikush



(Foto: Frrak Kolaj)

mund të thotë se vitet e para kanë qenë më të veçanta në lidhje me gëzimin dhe entuziazmin fillestar për krijimin e një qendre katolike shqiptare. Dikush tjetër mund të mendojë se vitet më të rëndësishme dhe më të veçanta kanë qenë ato të luftës dhe të pasluftës së Kosovës, për faktin se solidarizimi dhe bashkimi i mërgatës shqiptare ishte jashtëzakonisht i madh. Krejt në fund mund të shtojmë se vitet më të mira janë ato që janë para nesh.

Cili është qëllimi i Misionit tonë? Një proverb afrikan thotë: "Po deshe të ecësh shpejt, ec vetëm. Po deshe të ecësh larg, ec së bashku me të tjerët."

Të dashur pjesëmarrës, Misioni ynë ka përpara vetes një rrugë tejet të gjatë, të cilën duam ta përshkojmë së bashku. Kjo është rruga e humanizmit, rruga e shërbimit dhe e sakrificës, rruga që e përshkuan shumë atdhetarë dhe liridashës para nesh: është rruga e Gjergj Kastriotit, rruga e Pjetër Bogdanit, rruga e Nënë Terezës, rruga e Ibrahim Rugovës, rruga e Anton Çetës. Kush ec kësaj rruge, nuk lodhet kurrë: Ai është i bekuar për amshim, sepse kjo rrugë shpie te e Vërteta dhe Jeta.

I bindur se Krishti, që tha: "Unë jam Udhë, e Vërteta dhe Jeta" (Gjn 14, 6), do të na shoqërojë edhe në të ardhmen sikurse në të kaluarën, edhe një herë ju falënderojmë përzemërsisht për praninë tuaj dhe ju dëshirojmë mirëseardhje në mesin tonë!

Një falënderim i veçantë krejt në fund u shkon të gjithë atyre që na ndihmuar qoftë materialisht apo edhe me shërbime të ndryshme përgatitore dhe ushqimore.

Zoti e shpërbleftë të kaluarën, e bekoftë të tashmen dhe e drejtoftë të ardhmen e Misionit tonë!

Zoti e bekoftë popullin tonë shqiptar! Zoti e bekoftë Zvicren!

*Dr. Don Anton Uka
Drejtuës i Misionit Katolik Shqiptar
në Luzern*



TË NXITUR NGA NËNË TEREZA PËR VEPRA DASHURIE – BAMIRËSIE

(Foto: Don Marjan Ukej)

Para 32 vitesh, në Pranverën e Madhe Shqiptare në Kosovë (1990), kanë ndodhur disa ngjarje tejet të rëndësishme, mendoj historike, së paku për kohën dhe për hapësirat tona. Tani në mënyrë retrospektive mund t'i kuptojmë dhe vlerësojmë më mirë dhe më saktë.

Pajtimi i gjaqeve, apo lufta kundër gjak- apo hakmarrjes, e cila s'ishte tjetër përpos vetëvrasjes, vëllavrasjes dhe së fundi edhe vrasjes, "drejtësi" arbitrare, tejet e egër dhe jonjerëzore, si pasojë e së kaluarës së rëndë nën sundimin e të tjerëve, mungesës së drejtësisë dhe shtetësisë, lirisht mund të themi edhe "kanceri" i shoqërisë shqiptare, në krye me Prof. Anton Çetën dhe bashkëpunëtorët e shumtë, mbi të gjitha rininë tone.

Themelimi i Shoqatës Humanitare Bamirëse të Kosovës "Nëna Tereze", për ballafaqim me largime masovike prej punës, varfëri dhe diskriminim ndaj të gjithë atyre që nuk u gjuhëzuan para përndjekjeve dhe diktaturës së Serbisë, e cila kishte për qëllim largimin e shqiptarëve nga trojet tona, deri edhe përgjysmimin dhe shfarosjen, si dhe dorëzimin dhe manipulimin nëpërmjet papunësisë dhe varfërisë së skajshme. Janë themeluar në Kosovë 44 degë dhe 636 nëndegë, si dhe formimi i degëve gati në të gjitha shtetet e Evropës, në veçanti në Zvicër. Kemi pasur 7200 vullnetarë për grumbullimin dhe shpërndarjen e ndihmave; 58 donatorë ndërkom-bëtar. Gjatë Luftës mars-qershor 1999 janë ndihmuar mbi 900.000 persona. Shpirt dhe zemër e kësaj lëvizjeje bamirëse pothuaj unike ishte prof. Jak Mita dhe bashkëpunëtorët.

Krijimi i sistemit paralel shkollor i quajtur "Motrat Qiriazit", si luftë kundër analfabetizmit, që

kishte për qëllim fisnik ruajtjen dhe kultivimin e gjuhës, traditës, kulturës dhe shkollës shqip, si parakusht për identitetin dhe personalitetin tonë.

Krijimi i sistemit paralel në shëndetësi, për ta mbrojtur jetën njerëzore në çdo kusht dhe rrethanë me shërbime shëndetësore falas, me kujdes, përkushtim dhe dashuri vëllazërore, në krye me të ndjerin Dr. Gani Demollin dhe bashkëpunëtorët e tij.

Në këto lëvizje madhështore protagonist ishte POPULLI SHQIPTAR NË KOSOVË, por edhe mërgata jonë, sidomos ju në Zvicër, që me mençuri, urti dhe dashuri tejkalonte çdo kufizim, paragjykim, rrezikim, me takime, afrime dhe bashkime shembullore për t'i dëshmuar vlerat dhe virtytet e lashta dhe aktuale. Vëllazërisht dhe bashkërisht i përballuam të gjitha: skamjen, dhunën, heqjen e autonomisë së Kosovës, rrahjet, burgimet, vrasjet, dhe ia dolëm jo vetëm të mbijetojmë, por të përforcohemi dhe të bashkohemi pa kurrfarë dallimi, si një trup i vetëm me shumë gjymtyrë. Kështu u krijua ndjenja e përkatësisë së përbashkët, ndjenja e bamirësisë dhe solidaritetit, duke vërtetuar thënien e moçme shqiptare: "Nëse dëshiron t'i ndihmoh vetvetes, atëherë ndihmoju të tjerëve, sepse kështu do të ndihmojë Zoti dhe të tjerët".

Ndodhi mrekullia e bashkimit dhe bashkëpunimit: u falen 1275 gjaqe botërisht vetëm deri më 1 maj 1990, duke mposhtur urrejtjen, përçarjet, vrasjet me ndërrimin rrënjësor të botëkuptimit dhe të veprimit. Armiqësia u shndërrua në miqësi, vdekja në jetë, urrejtja në falje, miqësi dhe në dashuri.

Popullata ishte pa punë, pa ligj dhe mbrojtje, pa asgjë, e anësuar, e përbuzur dhe e përjashtuar prej sistemit politik dhe shoqëror. Atëherë gjetëm fuqi

dhe mënyrë për t'iu kthye vetvetes dhe të vërtetës duke kuptuar se të gjithë gjendemi para sfidave vendimtare, ose do të jetë mirë për të gjithë ose për askënd.

Nëpërmjet SHHB “Nëna Tereze” e gjetëmamarin e bujarisë dhe të bamirësisë shekullore ilire, arbërore dhe shqiptare, e mishëruam Nënëntonë Tereze në mendje dhe në zemër të çdo njeriut me përbetimin tonë fisnik dhe profetik: “As të fikur as te koritur!”.

Dhe kështu garuam për ta kuptuar, përkrahur ndihmuar, dhe dashur njëri-tjetrin deri te flijimi dhe dhurimi i skajshëm për shpëtim, liri dhe demokraci.

Jetuam dhe mbijetuam çdo gjë, duke iu falënderuar Provanisë Hyjnore, bamirësisë vëllazërore gjithshqiptare dhe ndërkombëtare, siç thoshte i ndjeri Imzot Nikë Prela, sepse “provuam çdo gjë përpos varrit.”

Kjo vetëdije, kjo histori, ky aktualitet na ka mbajtur gjithnjë të bashkuar dhe të vëllazëruar për të tashmen dhe për ardhmërinë tonë.

Manifestimi dhe kremtimi i sotëm në Misionin Katolik Shqiptar në Luzern është vetëm një përkujtim i thjeshtë, në stilin e Nënës Tereze, i zbehtë dhe gjithëpërfshirës i asaj që ndodhi ndër ne dhe me ne, mrekullia e urtisë, frymëzimi i dashurisë dhe vëllazërisë, bashkëpunimit dhe guximit në të mirë dhe në dobi të të gjithëve.

Bamirësia s'ka nevojë për lavdi, për reklamë, për mirënjohje, për falënderime, sepse ajo lind nga zemra dhe iu dhurohet zemrave, atyre që ishin dhe janë ende të kërcënuar dhe të rrezikuar. Bamirësia, nderimi dhe dashuria është BORXHI më i madh jetësor për çdo njeri, të cilin është tejet vështirë ta lajmë në këtë jetë dhe botë.

Bëmë atë çka ditëm dhe mundem. Këtë le ta vlerësojë Zoti dhe populli. Për ne vlen motoja latine: “SERVIRE EST REGNARE” - të shërbesh domethënë të mbretërosh. Ne patëm këtë privilegj që të jemi afër popullit të kërcënuar dhe të rrezikuar, dhe ndamë me të jo vetëm kafshatën e gojës, por çdo gjë, veçmas dhembjen dhe pikëllimin e zemrës. E kur jemi së bashku në të vështira, kjo na përgatit që të jemi të tillë edhe në të mira.

Diktaturës ditëm t'i përgjigjemi me strategjinë paqësore jodhunore gandiane, edhe më mirë të themi tereziane, në krye me Presidentin historik

dhe të parë të Kosovës, dr. Ibrahim Rugovën, me solidaritet të pashoq në bamirësi, me pajtimet e gjaqeve, me krijimin e sistemeve paralele shkollore dhe shëndetësore, kur qe nevoja edhe me luftën tonë të lavdishme të UÇK-së.

Tani prapë, si gjithmonë, na duhet ndihma e Zotit, përkrahja e bashkësisë ndërkombëtare, mbi të gjitha bashkimi dhe vëllazërimi ynë, për sfidat dhe sprovat e reja tejet të rëndësishme, për krijimin dhe kultivimin e kulturës së jetës dhe qytetërimin e dashurisë.

Me Nënëntereze e kemi gjetur letërnjoftimin apo pasaportën tonë për ne dhe për botën. Rruga drejt lirisë së plotë dhe pavarësisë kërkon prej nesh gjithnjë flijim dhe dhurim, punë dhe përgjegjësi, bashkërenditje dhe bashkëpunim, së pari mes nesh, pastaj edhe me të tjerët.

Falënderoj të gjithë bashkëpunëtorët tanë, e të tillë ishim pothuaj të gjithë, ne mënyra dhe rrethana të ndryshme, sepse kështu e kemi dhënë “pjesën më të mirë të vetvetes”, siç thotë Nënës Tereze, me veprimtari dhe krijimtari mirësie dhe bamirësie, duke “lavruar” ndërgjegjet tona me djersë, mund, lotë dhe gjak, duke mbjellur farën e të mirës, të drejtës, të vërtetës të jetës, të paqes dhe të dashurisë.

Ky “investim” në njeriun dhe për njeriun kurrë s'mund të jetë i kotë, gjithmonë jep fryte, sepse dashuria dhe vëllazëria është pema e çdo stine, moshe, gjinie, për të cilën të gjithë kemi nevojë. “Dashuria është përgjigjja më e mirë e jetës”, thotë Erich Frommi.

Le t'na përcjellë nga qielli Shën Nëna jonë Tereze, që edhe ne gjurmave të saja të shkojmë, atë ta duam dhe ta nderojmë, vetveten mos ta njollosim dhe robërojmë, por ta përparojmë dhe shpëtojmë me vepra mirësie, flijimi, dhurimi dhe dashurie.

Nëpërmjet Misioneve Katolike Shqiptare në Zvicër, por edhe gjetiu në Evropë dhe SHBA-a, Kanada, ne ofrojmë dhe mundësojmë ruajtjen e fesë, ngjalljen e shpresës, mbi të gjitha ndezjen e dashurisë, në stilin e Nënës, Tereze, për Zotin – Dashuri si dhe Vëllain apo Motrën – Njeri.

Urime dhe përgëzime vëllazërore për 30 – vjetorin e Misionit tonë në Luzern!



30-JAHRE-JUBILÄUM DER ALBANISCH-KATHOLISCHEN MISSION IN LUZERN

(Foto: Don Marjan Uka)

Sehr geehrter Herr Don Anton Uka, sehr geehrte Damen und Herren

Ich danke der albanisch-katholischen Mission für die Einladung. Es ist für mich eine Ehre, vor euch zu sprechen. Ich bin in Sursee aufgewachsen. Im gleichen Block wohnte auch die Familie Bullakaj, die die Sonntagsmesse regelmässig besuchten. Ich kann mich als Kind erinnern, wie ich ein bisschen neidisch war, dass sie einen Ort hatten, wo sie sich regelmässig treffen konnten.

Heute bin ich als Gast hier – das freut mich sehr. Ich gratuliere herzlich zum 30-jährigen Jubiläum.

In Kosovo werden wir oft gefragt: Ist es hier oder dort besser? In der Schweiz werden wir gefragt: Bist du mehr Albanerin oder Schweizerin? Wir, die hier leben und vor allem jene, die hier aufgewachsen sind, hat diese Frage in ein

Dilemma gebracht. Was verstehen wir unter Heimat? Ist Heimat ein Ort, eine Landschaft, ein Raum – oder vielleicht doch nur eine Erinnerung?

Ist es möglich, zwei oder mehrere Heimaten zu haben? Anlässlich einer Dankesrede sagte der Schriftsteller Max Frisch einmal: «Heimat, die (Plural: ungebräuchlich): wo jemand zu Hause ist; Land, Landesteil oder Ort, in dem man (geboren und) aufgewachsen ist oder ständigen Wohnsitz gehabt hat und sich geborgen fühlt oder fühlte».

Die Mission wurde zu einer Zeit gegründet, als sich die politische Situation in Kosovo verschlechterte und viele ihre Familien in die Schweiz nachzogen. In diesen 30 Jahren seit der Gründung der albanisch-katholischen Mission hat sich das Verhältnis zur Heimat gewandelt. Die Mission war von Anfang an ein Ort, der

weit über ihren Auftrag der Pflege des Glaubens hinausging. In diesen 30 Jahren zeigt sich auch eine interessante Integrationsgeschichte. Zu Beginn war es mehr eine Übersetzungsstelle, weil man sprachlich am Ankommen war. Dann wandelte es sich in eine Beratungsstelle und ging über in eine Integrationsstelle. Heute ist die zweite oder dritte Generation involviert und hier zeigt sich auch der Wandel. Die Mission hat diesen Wandel mitgemacht und sich auch verändert – darum ist sie heute immer noch ein beliebter Ort. Und in diesem Wandel stecken wir immer noch. Nicht erst seit 30 Jahren, sondern seit die ersten Albaner:innen in die Schweiz kamen.

Ich lebe genau seit 30 Jahren in der Schweiz. Wer hätte das gedacht, vor 30 Jahren – dass jemand von uns Kantonsratspräsidentin oder Regierungsratskandidatin werden kann? Selbstverständlich will ich damit nicht all die Schwierigkeiten und auch Diskriminierungen unerwähnt lassen, die Menschen aus dem Kosovo erlebt haben. Auch hier hat sich einiges zum Guten verändert.

In so einem Wandel stellen sich immer auch Fragen der Identität und Zugehörigkeit, die Angst vor Verlust der Wurzeln, Verlust der Sprache und der Kultur. Es gibt hier auch Generationenkonflikte. Es geht um Fragen, was bewahren oder was verändern wir. Hier ist der Dialog wichtig, das Dranbleiben und Aushalten von unterschiedlichen Meinungen ebenso. Ich bin überzeugt: Wir als Gesellschaft können uns aber nur weiterentwickeln, wenn die Frauen die gleichen Rechte haben und sich auch Rollenbilder verändern. Hier hat nicht nur die Kirche Herausforderungen, sondern alle Religionsgemeinschaften. Auch wir als albanische Gemeinschaft müssen über unangenehme Themen reden. Zum Beispiel über Gewalt an Frauen, über Rollenbilder oder dass junge Menschen ihre:n Partner:in selber wählen können. Ob mein Kind albanisch spricht oder die albanische Kultur gepflegt wird, hat

nichts damit zu tun, ob ich mit einem Schweizer verheiratet bin oder nicht, sondern ob mir die Vermittlung der Sprache und Kultur wichtig ist! Das erste Wort meines 16 Monate alten Sohnes war: Drita («Licht»). Ich muss zugeben, dass mir gewisse Worte in der Muttersprache fehlen. Rossschnecke in Albanisch? Kermill i zhveshur («Nacktschnecke»?). Viel wichtiger als die korrekte Sprache ist mir, ihm Werte des Respekts, Solidarität, Gerechtigkeit und Gastfreundschaft mitzugeben. Anlässlich der Annahme meiner Wahl zur Luzerner Kantonsratspräsidentin im Juni 2020 sagte ich: «Die Schweiz ist ein kleines Land. Aber die Schweiz macht grosse Träume möglich.» Die Schweiz macht es möglich, weil sich hier Menschen – wie ihr alle hier – tagtäglich dafür

einsetzen, hier bei der Mission, andere in einen Fussballverein, wieder andere hüten Enkelkinder. Ich danke all jenen der ersten Generation für ihren Einsatz. Ohne sie würden wir nicht hier stehen. Wir haben ihnen so vieles zu verdanken. Sie haben für uns viel geopfert und uns ihre Liebe und Zuversicht mitgegeben – dafür ihre Träume und Sehnsüchte aufgegeben, damit wir jüngere Generation eine bessere Zukunft haben.

Was antworten wir heute auf die Fragen: Ist es besser hier oder dort? Bist du mehr Albanerin oder Schweizerin? Heute bringen mich diese Fragen nicht in ein Dilemma und ich antworte: Ich fühle mich hier und dort wohl. Ich kann alles sein, Schweizerin und Albanerin.

Ich bin überzeugt: Heimatliebe kann nur entstehen, wenn wir so sein dürfen wie wir sind. Nämlich Menschen mit mehreren Zugehörigkeiten sowie mehreren Orten, wo man sich beheimatet fühlt.

Herzlichen Dank.

*Ylfete Fanaj,
Kantonsrätin und
Regierungsratskandidatin*



Përshëndetje për të gjithë!
Hapja e Misionit Katolik Shqiptar, para 30-të vjetësh, këtu, në Lucernë të Zvicrës, ka qenë dhe është një bekim i madh i Zotit për komunitetin shqiptar, ‘misioni, thotë Papa Françesku, është zemra e Kishës’ dhe shpall praninë e Zotit në çdo komb dhe kulturë, ky Mision përfaqëson dhe pasqyron frytin e asaj përkujdesjeje amtare që Kisha katolike ka pasur kurdoherë në histori dhe ka ende sot për çdo bij e bir të saj, kudo që gjendet. Misionit Katolik Shqiptar në Lucernë me nisma, programe, kremtime e dëshmi, ngul këmbë mbi vlerën e bashkimit themelor që i lidh ndërmjet tyre të gjithë shqiptarët, pa dallim, besimtarë e jo, që gjenden në Zvicër

Prandaj, Qendra e Misionit Katolik Shqiptar në Lucernë është vërtetë një «thesar i çmuar», një vatër dhe shkollë, ku kultivohen virtytet si dhuratë që i jep kuptim e shpresë jetës, ku kultivohet identiteti dhe hapen horizonte njerëzore e shoqërore për çdo shqiptar.

Misionari i sotëm dom Anton Uka, ashtu si para tij dom Aleksandër Kola, dom Marjan Marku, dom Marjan Demaj, dom Agim Qerkini, don Marjan Lorenci, atë dhe mësues, përmes Misionit Katolik Shqiptar në Lucernë, u shërbejnë të bijve të Zotit e vëllezërve në të gjitha çastet dhe situatat e lume e të shqeta të jetës.

Dom Anton Uka, për këtë rast të veçantë e

tejet të bukur të këtij Jubileu, më kanë kërkuar të prezantoj shkurt, Mesazhin e Papës Françesku për Ditën Botërore të Misioneve 2022, që kremtohet të dielën më 23 tetor 2022, në gjitha Kishat katolike kudo në botë.

Siç dihet mesazhi i Papës për Ditën Misionare 2022 ka për temë “Ju do të jeni dëshmitarë të mi” marr nga Veprat e Apostujve (Vp 1,8), është shpallur në festën e Dëftimit të Zotit, më 6 janarin e këtij viti, frymëzohet nga fjalët e Jezusit që kemi në Veprat e Apostujve dhe reflekton mbi frazat kyçe, që përshkruajnë jetën dhe misionin e dishepujve. Mesazhi i Papës Françesku ndahet në tri pjesë kryesore:

1. «Ju do të jeni dëshmitarë të mi» - Thirrja e të gjithë të krishterëve për të dëshmuar Krishtin;
2. «Deri në skajet e tokës» - Aktualiteti i përhershëm i misionit të ungjillëzimit universal
3. «Do të merrni forcën e Shpirtit Shenjt» – Lejojeni gjithnjë Shpirtin Shenjt të ju forcojë dhe t’ju drejtojë.

Ju do të jeni dëshmitarët e mi

«Ju do të jeni dëshmitarët e mi», «deri në skajet e tokës» dhe «ju do të merrni forcë nga Shpirti Shenjt». Për Papën Bergoglio, këto janë tri shprehjet kryesore, që përmbledhin tre bazat e jetës dhe të misionit të dishepujve.

Të gjithë të krishterët janë të thirrur për të

dëshmuar Krishtin. Kjo “është pika qendrore, thelbi i mësimit të Jezusit për dishepujt, në prag të misionit të tyre në botë. Të gjithë dishepujt do të jenë dëshmitarë të Jezusit, falë Shpirtit Shenjt Zot që do të marrin: do të formohen si të tillë me anë të Hirit Hyjnor. Kudo të shkojnë, kudo të jenë - komenton Papa frazën e parë - identiteti i Kishës është ungjillëzimi».

Aktualiteti i përhershëm i misionit

Prania e besimtarëve me kombësi të ndryshme e pasuron Kishën. «Diçka e ngjashme ndodh ende në kohën tonë”, pohon Papa e sh-ton “për shkak të persekutimeve fetare, luftës dhe dhunës, shumë të krishterë detyrohen të ikin ende sot nga toka e tyre në vende të tjera. Ne u jemi mirënjohës këtyre vëllezërve dhe motrave, që nuk mbyllen në vuajtje, por dëshmojnë Krishtin dhe dashurinë e Zotit në vendet, që i mirëpresin. Vërtet, gjithnjë e më shumë, shohim se si prania e besimtarëve të kombësive të ndryshme e pasuron imazhin e famullive kishtarë dhe i bën ato më universale, më katolike. Për rrjedhojë, kujdesi baritor për migrantët është veprimtari misionare, që s’duhet lënë mënjanë, sepse mund t’i ndihmojë edhe besimtarët vendas të rizbulojnë gëzimin e fesë së krishterë”, komenton Papa.

Për Atin e Shenjtë Françesku «Kisha e Krishtit ishte, është dhe do të jetë gjithmonë ‘në dalje’ drejt horizonteve të reja gjeografike, shoqërore, ekzistenciale, drejt vendeve dhe gjendjeve njerëzore ‘kufitare’, për të dëshmuar Krishtin dhe dashurinë e Tij për të gjithë burrat dhe gratë e çdo populli, kulture, gjendjeje shoqërore”.

Merrni forcë nga Shpirti Shenjt

Pjesa e tretë dhe e fundit e Mesazhit të Papës Bergoglio është «Do të merrni forcë nga Shpirti Shenjt – Lejojeni gjithnjë Shpirtin Shenjt t’ju forcojë e t’ju drejtojë”. “Asnjë i krishterë nuk do të jetë në gjendje të japë dëshmi të plotë dhe të vërtetë për Krishtin Zot pa frymë-

zimin dhe pa ndihmën e Shpirtit - pohon Papa. - Çdo dishepull misionar i Krishtit është i thirrur ta kuptojë rëndësinë themelore të veprimit të Shpirtit, të jetojë me të çdo ditë dhe të marrë vazhdimisht forcë dhe frymëzim prej tij». “Shpirti Shenjt është protagonist i vërtetë i misionit: është Ai që na e dhuron fjalën e duhur, në çastin e duhur, në mënyrën e duhur”, thekson Papa.

Misioni Katolik Shqiptar në Lucern, gjatë këtyre 30-vjetëve, si vatër e shkollë autentike shpirtërore e kombëtare ka punuar pikërisht në këtë hulli, duke propozuar Lajmin e Mirë, si bazë e gjithë jetës së krishterë e njerëzore. Ka dëshmuar dhe përhapur Lajmin e Mirë, e njëkohësisht ka ruajtur dhe kultivuar gjuhën, kulturën, virtytet dhe përforcuar identitetin kombëtar të shqiptarëve në mërgim, pa lënë anash rëndësinë e integritit të tyre në shoqërinë e shtetit ku jetojnë. Ka ndjekur, kështu, binomin e klerit katolik shqiptar gjatë shekujsh per ‘Atmë e Fé’. Misionit Katolik Shqiptar në Lucernë i ndihmon shqiptarët të ritakohet me Zotin dhe me njëri-tjetrin, për këtë ka punuar dhe vazhdon veprimtarinë me një përkushtim të pakursyer, duke nënvizuar përherë rëndësinë e të qenurit vatër vëllazërimi, kombi, feje dhe shprese.

Kështu, Kryqi i Jezu Krishtit dhe Shqiptarja e Flamurit Shqiptar na tregojnë udhën dhe përforcojnë shpresën, për një jetë me dashuri, në shërbim të Zotit e të njëri-tjetrit.

Duke ju falënderuar edhe një herë për ftesën dhe vëmendjen, duan të përfundoj me përgëzimet e përzemërta dhe urimet Misionit Katolik Shqiptar në Lucernë, me fjalët Papës, ‘për një stinë të re veprimi misionar’ me të mira e bekime prej Zotit.

(Kjo është kumtesa e dërguar nga Don David Xhuxha, përgjegjës i Radio Vatikanit në gjuhën shqipe, i cili për shkaqe shëndetësore nuk mundi të jetë i pranishëm në akademinë shkencore. Kumtesa është lexuar nga Barbara Merturi.)

SIMBOLET E KRISHTLINDJES DHE DOMETHËNIA E TYRE



Festa e Krishtlindjes dhe ajo e Pashkëve janë festat më të rëndësishme të besimit të krishterë. Që të dyja këto kanë në qendër personin e Krishtit dhe porosinë e tij për mbarë njerëzimin.

Për sa i përket festës së Krishtlindjes, duhet theksuar se secili popull dhe secila kulturë e krishterë ka traditat dhe simbolet e veta përmes të cilave feston lindjen apo ditëlindjen e Jezusit. Edhe populli ynë shqiptar, si ndër më të lashtët në Evropë dhe ndër të parët që e pranuan krishterimin prej vetë nxënësve të Krishtit, përmes simboleve të Krishtlindjes kremton dhe e përjeton festën e mishërimit dhe të lindjes së Krishtit Zot.

Tashmë, në muajin dhjetor, pothuajse të gjitha familjet shqiptare, pra edhe ato që nuk i përkasin më besimit të gjyshërve apo stërgjyshërve të tyre, në shtëpitë e tyre vendosin një shenjë apo një simbol që ndërlidhet me festën e Krishtlindjes, por ndoshta jo të gjithë e njohin kuptimin dhe domethënien e tyre. Kjo është arsyeja që përmes këtij shkrimi, shkurtimisht, dëshiroj të shpjegoj kuptimin dhe domethënien e simboleve më të rëndësishme të festës së krishtlindjes.

Ylli i Betlehemit

Ylli i Krishtlindjeve simbolizon yllin e Betlehemit i cili ndriçoi dhe udhëzoi tre mbretërit, Mel-

kiorin, Baltazarin dhe Gaspërin, për të arritur tek foshnja Jezus dhe për ta adhuruar atë. Këta tre mbretër sollën dhurata prej ari, temjani (kem) dhe mirre. Pra ky yll i tregon këtyre njerëzve se ku ishte Jezusi. Quket ylli i Betlehemit sepse dijetarët i udhëzoi drejt qytetit të Betlehemit, pra drejt vendit ku kishte lindur Jezusi. Në kuptimin simbolik, ky yll simbolizon vetë personin e Krishtit i cili dëshiron t'i ndriçojë dhe t'i udhëzojë të gjithë njerëzit tek njohja dhe pranimi i Hyjit.

Këmbanat

Këmbana të cilat zakonisht i vendosim në bredhin e Krishtlindjes apo në ambientet e tjera simbolizojnë lajmin e gëzueshëm se në qytetin e Davidit lindi Krishti Mbret. Këmbanat paralajmërojnë njerëzit për një ngjarje dhe njëkohësisht i ftojnë ata që të mblidhen e ta festojnë atë. Simbolizojnë lajmin e mirë që dëshiron të arrijë në zemrën dhe në mendjen e secilit njeri.

Topat dekorues

Topat e larmishëm dekorues që vendosen në bredhin e Krishtlindjes apo në shpellën e Betlehemit janë simbol i fryteve të shumta që sjell lindja e Krishtit. Duke i vendosur topat në pemën e Krishtlindjes, sikur duam që edhe jeta dhe familjet tona të mbushën me të mira shpirtërore dhe materiale.

Dritëzat

Dritat të cilat i vendosim në bredh, në betlehem, nëpër shtëpi, në rrugë apo edhe në vende dhe ambiente të tjera, simbolizojnë dritën e Krishtit që ndriçon njerëzimin. Përmes vendosjes së dritave sikur dëshirojmë t'i themi dritës së Krishtit eja në zemrat dhe në ambientet tona, sepse ne që shumë herë ndodhemi në errësirë, kemi nevojë për dritën tënde.

Bredhi i Krishtlindjes



(Foto: Pixabay)

të treguar se në Jezusin kemi jetën e përhershme dhe të mirat e nevojshme për një jetë të mirë, të drejtë dhe të shenjtë. Jeta në Krishtin është e pavdekshme.

Bredhi i Krishtlindjes, para se gjithash, simbolizon jetën dhe shpresën. Bredhi është njëri prej pak drunjve që edhe në stinën e dimrit e ruan gjelbërimin, pra është përherë i gjelbër. Kjo është arsyeja përse bredhi filloi të përdoret për Krishtlindje, pikërisht për

të ngjizë dhe do të lindë Mesinë, e deri tek shpallja se Krishti është ringjallë, zënë një vend të pazëvendësueshëm në historinë e Jezusit. Engjëjt janë lajmëtarët e parë të lindjes së Krishtit, kjo është arsyeja përse ata zënë një vend krejt të veçantë në dekorimet e Krishtlindjes. Vendosja e engjëjve në betlehem apo në bredhin e Krishtlindjes bëhet, para se gjithash, për të treguar se ata dëshirojnë të sjellin lajme të mira dhe gëzim në jetën e njeriut, por edhe për të treguar se ata dëshirojnë t'i mbrojnë shtëpitë tona dhe banuesit e tyre,

Betlehemi

Betlehemi, i menduar dhe i krijuar nga Shën Françesku i Asizit, është një paraqitje në miniatyrë e qytetit dhe vendit ku ka lindur Jezusi. Në këtë paraqitje apo në këtë skenë, përveç Foshnjës hyjnore dhe prindërve të tij, Marisë dhe Jozeffit, aty figurojnë edhe kafshët, barinjët, tre mbretërit dhe ylli ndriçues. Rregullimi i Betlehemit në shtëpia dhe në Kisha, përveçse të tregojë historinë e lindjes së Jezusit, ai po ashtu është edhe një thirrje në mënyrë që shtëpitë tona të shndërrohen në një ambient ku dëshiron të lindë Jezusi.

Engjëjt

Engjëjt nga momenti i lajmërimit se Maria do

Shkruan: don Anton Uka

Përsiatje

Sa e pastër është të bashkëndjesh ndaj situatave që ndodhin rreth nesh e larg nesh.

Kur tjetri dëmtohet, ti s'je aktor, por reagues.

Kur tjetri lëndohet, ti s'je aktor, por ngushëllues.

Kur tjetri vuan, ti s'je aktor, por shpresëdhënës.

Kur tjetri rrëzohet, ti s'je aktor, por ja shtrin dorën.

Kur tjetri qan, ti s'je aktor, por i ofron përqafimin.

Kur tjetri gëzon, ti s'je aktor ziliqar, por gëzon me të.

Kur tjetri vuan skamjen e bukës, të veshjes ose të strehës, kudo nëpër botë, ti s'je aktor, por përpiqesh t'i afrosh një pallto, pak bukë nga shporta jote, e strehe në tendën tënde.

Dhembshuria e vërtetë s'është superioritet ndaj tjetrit, as mirësia për nder të mirënjohjes, është zbulim zemre se ekzistoj, sepse ekzistojmë!

Kjo është Krishtlindja!

Shkruan: Daniell David Ukaj

Janar 2023**01.01.2023**

11:00 Mesha në Inwil ZG
 13:30 Mesha në Sursee
 18:00 Mesha në Giornico TI

06.01.2023

19:30 Mesha në Luzern

08.01.2023

13:30 Mesha në Emmenbrücke
 17:00 Mesha në Willisau

15.01.2023

10:30 Mesha në Goldau
 13:30 S Mesha në Sursee

22.01.2023

11:00 Mesha në Inwil ZG
 13:30 Mesha në Emmenbrücke
 17:00 Mesha në Menznau

29.01.2023

13:30 Mesha në Emmenbrücke

Shkurt 2023**02.02.2023**

19:30 Mesha në Luzern

03.02.2023

18:30 E premtja e I e muajit, Mesha në Luzern

05.02.2023

11:00 Mesha në Inwil ZG
 13:30 Mesha në Sursee
 18:00 Mesha në Giornico TI

11.02.2023

19:30 Zoja e Lurdit - Mesha në Luzern

12.02.2023

13:30 Mesha në Emmenbrücke
 17:00 Mesha në Willisau

19.02.2023

10:30 Mesha në Goldau
 13:30 Mesha në Sursee

24.02.2023

19:30 Udha e Kryqit dhe Mesha në Emmenbrücke

25.02.2023

16:30 Ripërtëritja shpirtërore për fëmijët në Luzern
 19:00 Prejra e flokëve - Bamirësi

26.02.2023

11:00 Mesha në Inwil ZG
 13:30 Mesha në Emmenbrücke
 17:00 Mesha në Menznau

Mars 2023**03.03.2023**

19:30 Udha e Kryqit dhe Mesha në Emmenbrücke

04.03.2023

18:00 Mesha në Vetroz

05.03.2023

11:00 Mesha në Inwil ZG
 13:30 Mesha në Sursee
 18:00 Mesha në Giornico TI

10.03.2023

19:30 Udha e Kryqit dhe Mesha në Emmenbrücke

11.03.2023

19:30 Festa e përvjetorit të Korit në Luzern

12.03.2023

13:30 Mesha në Emmenbrücke
 17:00 Mesha në Willisau

14.03.2023

9:00 Mesha në Luzern

19:30 Mesha në Emmenbrücke

17.03.2023

19:30 Udhë e Kryqit dhe Mesha në Emmenbrücke

19.03.2023

10:30 Mesha në Goldau

13:30 Mesha në Sursee

17:00 Ripërtëritja shpirtërore për të rinjtë në Luzern

21.03.2023

9:00 Mesha në Luzern

19:30 Mesha në Emmenbrücke

24.03.2023

19:30 Udhë e Kryqit dhe Mesha në Emmenbrücke

25.03.2023

Turniri me Ping-Pong në Luzern – Bamirësi

26.03.2023

11:00 Mesha në Inwil ZG

13:30 Mesha në Emmenbrücke

17:00 Mesha në Menznau

28.03.2023

9:00 Mesha në Luzern

19:30 Mesha në Emmenbrücke

31.03.2023

Seminari shpirtëror

19:30 Udhë e Kryqit dhe Mesha në Emmenbrücke

Qendra e dëgjimit

Duke e parë nevojën e shumë njerëzve për t'i dëgjuar, këshilluar dhe ndihmuar në kapërcimin e sfidave dhe problemeve të tyre, tashmë para 1 viti, kemi vendosur që në Misionin tonë të bëjmë hapjen e një Qendre të Dëgjimit.

Kjo Qendër do të jetë e hapur çdo të shtune, paradite. Nëse rastet dhe nevojat janë urgjente, rezervimi është i mundur edhe për ditët tjera të javës. Seancat apo takimet i udhëheq don Anton Uka, ato zgjasin 45 minuta.

Rezervimi është i detyrueshëm.



PËRGATITJA PËR KURORËZIM

Familja e bashkuar është bërthama e një shoqërie dhe kishë të shëndoshë. Përgatitjet për kurorëzim kishtar kanë për qëllim vetëdijesimin ndaj përgjegjësive që të martuarit kanë ndaj njëri-tjetrit dhe familjes. Prandaj, të gjithë ata që kanë për tu kurorëzuar gjatë vitit 2022, i ftojme që të lajmërohen në qendrën e Misionit tonë.

Kalendari i takimeve përgatitore për kurorëzim kishtarë është në këto data:

26 maj 2023, ora 20:00, në Luzern;

02 qershor 2023, ora 20:00, në Luzern;

09 qershor 2023, ora 20:00, në Luzern.

Të martet e Shna Ndout

Në vitin 2023 të martet kushtuar Shna Ndout fillojnë me 14 mars. Devocioni i 13-të të Marteve kushtuar shenjtit të dashur të mrekullive të shumta është një traditë e lashtë e Kishës dhe shumë e dashur për besimtarët tanë.

Në Misionin tonë do të kemi dy Meshë të shenjta: Luzern, në orën 9:00, Emmenbrücke, në orën 19:30

**AZB 6005 Luzern
Post CH AG**
Erscheint 4 x jährlich

Redaktionsschluss:
Nr. 1/2023
15. März 2023

Erscheint im
März 2023

Impressum
Misioni Katolik Shqiptar në Luzern
Katholische Albanische Mission in Luzern

Verlag und Redaktion
Dr. Don Anton Uka, Përgjegjës
Rodteggstrasse 6
CH-6005 Luzern
Tel: +41 41 250 52 60
Fax: +41 41 250 52 67
Cel: +41 79 371 68 91
E-Mail: ukas_cr@hotmail.com
anton.uka@migrantenseelsorge-luzern.ch
Mitteilungsblatt für die Mitglieder des Vereins
der Katholischen Albanischen Mission in Luzern.

In memoriam: Flora Lazri (1976-2022)

Më 28 tetor, në Kishën Katolike në Gerliswil, Emmenbrücke, në orën 9:15 don Anton Uka ka kremtuar Meshën e dritës për shpirtin e Flora Lazri. E ndjera Flora, pas një sëmundje të rëndë, ka ndërruar jetë në moshën 46 vjeçare. Bashkëshorti Pashku, tre fëmijët e saj, por edhe të gjithë familjarët e tjerë pikëllimin dhe mërzinë për vdekjen e personit të tyre më të dashur e kanë përjetuar me ndjenja feje dhe me bindjen se shpirti i Florës tashmë pushon në Mbretërinë e Hyjit.

Padyshim se vdekjet e tilla janë të rënda për familjarët, dhe është vështirë të gjenden fjalët e duhura për të ngushëlluar, megjithatë, për ne të krishterët, ngushëllimi dhe shpresa është Krishti dhe fjala e tij. Ai është jeta dhe të ringjallurit tonë. Pra baza e shpresës sonë është gjithmonë Jezusi. Edhe Ai e ka kaluar rrugën e kryqit, ka pranuar vdekjen dhe të tretën ditë është ngjallur së vdekuri. Ngjallja e Jezu Krishtit nuk do të thotë kthim në jetën e mëparshme, as lindje përsëri, por është shndërrim në jetë të re, ku njeriu

do të jetë gjithmonë i dashur dhe i pranuar prej Zotit.

Besojmë dhe shpresojmë se edhe e ndjera Flora është e dashur dhe e pranuar prej Zotit, sepse kishte besimin dhe dashurinë e madhe në të.

Besimi i krishterë nuk e fsheh vdekjen, as nuk e zvogëlon të vërtetën e hidhur të saj. Vdekja gjithmonë është dhimbje, tronditje, ndarje, ikje. Sidoqoftë, besimtari me besim në Krishtin e ringjallur nuk trishtohet porsitë tjerët që nuk kanë shpresë, do të thoshte Shën Pali (krhs. 1Sel 4,13). Ndërsa, Papa Gjon Pali II, tashmë shenjtë, vdekjen e krahasonte me një derë e cila lejon kalimin në jetën e pasosur.

Lusim Zotin dhe ndërmjetësimin e Zojës së Bekuar që Flora ta gëzojë jetën e pasosur dhe familja e saj të mund ta përballojë dhimbjen me fe dhe më shpresë se një ditë të gjithë së bashku do të takohemi dhe do të jetojmë në Krishtin.

Shkruan: m. Vida Ademi

Të ndihmojmë Misionin tonë!

Konto: CH24 0077 8155 5749 1200 3

Albaner Mission | Rodteggstrasse 6 | 6005 Luzern